

ROMEO GURAKUQI

MBI CAKTIMIN E KUFIRIT NDËRMJET SHQIPËRISË DHE GREQISË

1. Periudha e parë 1881-1914

Caktimi i kufirit politik në mes shtetit të fundit ballkanik të lindur nga shpërbërja e Turqisë europiane në vitin 1913, Principatës së Shqipërisë me Mbretërinë e Greqisë, ka qenë problem i mirëfilltë i fushës së politikës së jashtme, që ka implikuar jo vetëm palët e interesuara, por edhe Fuqitë e Mëdha. Kemi të bëjmë me një marrëdhënie të vështirë në mes dy kombeve, që do të përsëritet në forma të ndryshme, pas çdo krize ballkanike dhe botërore për gati 100 vitet që pasojnë në shek. XX.

Kjo marrëdhënie është e karakterizuar: 1. Nga një synim i qëndrueshëm i shtetit grek, për të pasur një kufi tokësor dhe detar sa më të kontrollueshëm në pikëpamje strategjike, pa marrë parasysh vlerësimin e së drejtës, bazuar mbi kritere etnografike, gjeografike, ekonomike e strategjike dhe prejardhjen e së drejtës bazuar në aktet ndërkombëtare, që fillojnë së paku nga Akti Final i Kongresit të Vjenës, 1815; 2. Nga një politikë pothuajse e pandjeshme e Greqisë zyrtare ndaj interesave nacionale, deotomanizuese dhe europianizuese të shqiptarëve dhe rreshtim pothuajse konstant i saj përkrah Serbisë dhe kundër Shqipërisë, edhe në çështje në të cilat Greqia kishte interes krejtësisht të largët (Kosova); 3. Një pamundësi konstante e shtetit shqiptar për të ndërtuar përfaqësime institucionale politike, që do të lehtësonin ushtrimin e mirëfilltë të integritetit territorial shtetëror dhe mundësonin gëzimin e lirisë për regjionet, me specifika etnike dhe religjioze; Mbi të gjitha shteti shqiptar do të dështojë në njohjen në vijimësi të përfaqësimeve të efektshme dhe të përshtatshme në të gjithë piramidën shtetërore, të veçantive të popullsisë mbi të cilën ushtron sovranitetin. Pengesën më të madhe ndaj ambicieve greke në Shqipërinë e Jugut, e kanë përbërë faktet e pamohueshme etnografike mbi të cilat u mbështetën Austro-Hungaria e Italia, dhe një grupim i forcave patriotike shqiptare, që kanë ditur të thonë fjalën e vet, në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha.

Problemi i vendosjes së një kufiri sa më optimal në pjesën veriore të Greqisë ka qenë një prej preokupacioneve të Mbretërisë së Greqisë, që nga fillimet e jetës së pavarur. Politika e rikompozimit shtetëror të Greqisë është ndërtuar duke u mbështetur në pretendime me konotacione antike. Epiri antik¹ ka qenë njëra nga këto krahina për të cilat politika e jashtme e Greqisë synoi së paku në tri raste, më 1854, 1878 dhe 1897 ta çonte situatën deri në agresion ose prag agresioni.² Deri në Kongresin e Berlinit, lufta për Epirin është zhvilluar midis Turqisë dhe Greqisë. Por, duke filluar nga viti 1878, me organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në ballafaqimin politik për Epirin hyri nacionalizmi shqiptar, dhe ashtu pa dashje ky nacionalizëm u rreshtua në një radhë përkrah Turqisë, që luftonte për ruajtjen e integritetit të perandorisë. Kjo ecje e shqiptarëve përkrah Turqisë për Epirin do të vazhdojë deri më 1913, kur Shqipëria e re do të duhej të qëndronte e vetme përballë Mbretërisë së

¹ Emri *Epir*, nga Antikiteti është përdorur për të emërtuar një trevë e cila në kuptimin më të ngushtë shtrihej që nga Saranda deri në Gjirin e Artës, por që në një kuptim më të gjerë *Epiri* shtrihej më në veri deri te Malet e Vetëtimës (Llogora dhe Gadishulli i Karaburunit), kurse në lindje kufirin e kësaj treve me Maqedoninë dhe Thesalinë e shënonin Malet e Pindit. Emërtimi *Epir* nga disa qarqe greke gjatë shekujve të fundit është përdorur për të gjithë Shqipërinë e Jugut deri në lumin Shkumbin. Emri *Epir* e ka burimin te fjala greke *Épeiros* “tokë (kontinentale)” (anglisht “*mainland*”) në kundërvënie me ishullin a ishujt përballë. Ky emërtim është përdorur nga grekët për ta dalluar këtë trevë nga ishujt përballë e sidomos nga ishulli i Korfuzit. Në kohët e njohura historike banorët shqipfolës të kësaj treve e quajnë veten, sipas viseve të tyre, përkatësisht *çamë*, *labë* a *arbëreshë dhe toskë*, kurse viset përkatëse ata i quajnë përkatësisht *Çamëri*, *Labëri* dhe *Toskëri*. *Labë* quhen banorët në perëndim të lumit Vjosa, kurse toskë të mirëfilltë janë banorët në lindje të atij lumi. Me kalimin e kohës emërtimet *toskë* dhe *Toskëri* janë përdorur edhe për të gjithë shqiptarët në jug të Shkumbinit. Ndaj ne ndonjëherë në këtë artikull do ta përdorim emërtimin *Toskëri* me të cilin ne nënkuptojmë gjithë Shqipërinë e Jugut natyrale. Për sa i përket gjuhës së folur në lashtësi në *Epir* ka pasur dhe ka mendime të ndryshme. Disa albanologë kanë arritur në përfundimin që fiset “*epirote*” flisnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja, pra ishin popullsi jogreke, një pjesë madje i kanë identifikuar me ilirët. Kurse studiues të tjerë, epirotët i konsideronin fis grek, ose të helenizuar. Se cila nga këto dy gjuhë apo popuj është parësor, këtë gjë nuk mund ta saktësojmë ende shkencërisht, por duhet të theksojmë se pas vitit 1821, d.m.th. pas shpalljes së pavarësisë së shtetit grek, dëshkohet një përhapje e vazhdueshme e greqishtes dhe një tkurrje e hapësirës së shqipes në viset në jug të kufirit shtetëror greko-shqiptar. Shih më hollësisht: Shaban Demiraj, *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*, Tiranë: Infbotues, 2008, f. 52, 53, 54, 57, 58.

² Luis Sigalos, *The Greek claims on Northern Epirus*, Chicago: Argonaut-INC, 1963, f. 15.

Greqisë, në mbrojtjen e të drejtave të veta territoriale në Shqipërinë e Jugut.

Kriza Lindore (1875-1878), i ofroi një mundësi shumë të mirë Greqisë për zgjerimin drejt Shqipërisë së Jugut (Epirit në tërësi). Neni 15 i Traktatit të Shën Stefanit, i formuluar posaçërisht nga Rusia, parashikonte që Epiri (edhe Thesalia) duhej të kishte të njëjtat privilegje për vetëqeverisjen lokale sikurse ato të akorduara prej të ashtuquajturit *reglement organique* të vitit 1868, për Kretën. Në Kongresin e Berlinit, përfaqësuesi i Greqisë, Delyannis u kërkoi përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha një kufi verior i cili do të duhej të përfshinte brenda këtij shteti edhe Epirin, Thesalinë, me lumenjtë Peneus dhe Kalamas dhe në mes tyre kufiri do shkonte nga Zygo dhe Meçovë afër burimit të Peneus, do duhej të ndiqte pastaj rrjedhën e lumit Vjosa deri në burimet e Kalamas-it. Pra, kufiri i propozuar për Epirin ishte shumë pak më në jug se sa kufiri aktual i Shqipërisë, i caktuar më 1913 nga Protokolli i Firences. Duke qenë se Turqia nuk mund ta pranonte një zgjerim të tillë të Greqisë, dhe asnjëra prej Fuqive të Mëdha, pavarësisht se e pranonin parimisht një zgjerim të këtij vendi, nuk donte të shkonte në luftë për t'ia imponuar këtë zgjerim. Çështja greke, në fakt, ishte një pjesëz e çështjes së ndërlikuar lindore dhe kongresi ishte mbledhur për të ndaluar ekspansionin e nisur nga Traktati i Shën Stefanit dhe për të minimizuar ndikimin rus në Ballkan. Me propozimin e delegatit francez Waddington, mbështetur nga ai italian Corti, në sesionin e 13 të tij, të mbajtur më 5 korrik 1878, Porta u ftua të punonte me Greqinë për rektifikimin e kufirit në Epir dhe Thesali. Kufiri i propozuar nga Waddington-i duhej të kalonte në luginën e Lumit Peneus në anën e detit Egje dhe do të vijonte në luginën e lumit Kallamas në anën e detit Jon, pra një kufi shumë afër propozimit që qeveria greke kishte bërë në kongres. Megjithatë, Kongresi i Berlinit e la çështjen e kufirit grek të hapur dhe në nenin 24 të tij bëri parashikimet për ndërmjetësim të Fuqive në rast se dy vendet nuk do të arrinin një kompromis të sugjeruar në sesionin e 13-të. Komisionet turko-greke janë mbledhur në fillim të vitit 1879 në Prevezë. Konferenca e Prevezës, edhe për shkak të presionit të palës shqiptare që doli tashmë si subjekt me pretendimet e veta, pas organizimit të Lidhjes së Prizrenit, dështoi. Konferenca u rimblodh në Kostandinopojë me mbikëqyrjen e ambasadoreve të fuqive më pas, por edhe kjo dështoi e atëherë Paddington-i propozoi që linja e kufirit duhej ta linte Janinën nën Turqi. Zgjidhja definitive ka ardhur më datë 24 maj 1881, me nënshkrimin e

Konventës së Kostandinopojës. Me anë të kësaj konvente, Greqia mernte pjesën më të madhe të Thesalisë dhe pjesë të Epirit, që formonin krahinën e Artës pranë kufirit të vitit 1832. Kufiri do të ndiqte linjën nga gryka e Karalik-Dervend, 3 milje në jug të Platamona-së dhe pak në veri të luginës së Tempe-s, drejt lumit ku është vendosur Arta; më pas drejt jugut përgjatë këtij lumi në Gjirin e Ambrakisë. *Ky kufi shënon përparimin e parë të Greqisë drejt Epirit, respektivisht Epirit të Jugut, pjesë e rëndësishme e territoreve që banoreshin edhe nga popullsi shqiptare, por jo vetëm.* Greqia do ta provojë edhe një herë një zgjerim të tillë më 1897, por pa sukses dhe në këtë mënyrë duhet të saktësojmë se ky përbënte përpjekjen e dytë të Greqisë drejt veriut, para përparimit të tretë të vitit 1913. Duhet të vëmë në dukje, se në kontekstin e propagandës greke pro Epirit, termi “Epir i Veriut” është një krijim i vitit 1913, mbasi deri në këtë vit kjo propagandë mjaft e sofistikuar nuk bënte dallim në ndarje të tilla dhe Epiri në tërësi, pra Shqipëria e Jugut dhe rajonet mikse të Janinës dhe rretheve të saj, deri në lumin Vjosë, ishte pjesë tërësore e një aspirote ekspansioniste.³


Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, u mor edhe me caktimin e kufirit mes Principatës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Greqisë. Në janar 1913, Austria propozoi një kufi jugor të Shqipërisë, që duhej të fillonte mes liqeneve të Ohrit dhe Prespës, më pas të shkonte drejt Lapsista-s drejt detit pranë Pargës. Duke qenë se në kohën kur austriakët e bënë këtë propozim, grekët nuk e kishin marrë ende me luftë Janinën, propozimi austriak e përfshinte edhe atë në Shqipëri. Duhet të themi paraprakisht se edhe pasi Janina do të kapitullonte, më 6 mars 1913, ambasadori italian në konferencë do bënte serish një propozim të ngjashëm për kufirin jugor të Shqipërisë, duke kërkuar që ky kufi të fillonte nga liqeni i Ohrit deri në grykëderdhjen e lumit Glykys.⁴

Pasi forcat ushtarake greke pushtuan pjesën më të madhe të Epirit, më 13 janar 1913, Kryeministri grek Venizelos, i drejtoi një memorandum Konferencës së Ambasadorëve në Londër, në të cilin kërkoi të drejtën e Greqisë për të aneksuar të gjitha territoret e pushtuara prej ushtrive të saj, d.m.th., tokat e ish vilajetit të Janinës dhe krahinat e Gjirokastrës e të Korçës. Memorandumi i qeverisë greke, i paraqitur në

³ Shih për më tepër: Basil J. Photos, *The History of Northern Epirus through postage Stamps*, Chicago: Argonaut, INC, 1963, f. 3.

⁴ PRO.FO.371.1999, doc.no.24133/128, Greece, Raporti vjetor, 1913. Sër. F. Elliot për sër Edward Grey, Athinë, 20 maj 1914.

Konferencën e Ambasadorëve, hiqte dorë nga pretendimet greke mbi Vlorën. Kufiri i kërkuar prej tyre duhet të fillonte diku në jug të Qafës së Llogorasë (Gjirin e Gramala-s) në veriperëndim të Palasës, dhe me një linjë harkore linte Tepelenën, Këlcyrën, Voskopojën dhe Korçën në Greqi.⁵



PRO.FO.925/ 21064, Albania, Trace de frontiere proposee par la Grece pour l'Epire

⁵ PRO.FO.925.21033. Kufiri jugor sipas propozimit të Greqisë (MS line) shënuar në 2 fletë nga stafi i gjeneralit austriak, harta 1: 300000, 1913.



PRO.FO.925.21033

Duke abuzuar me barazimin e besimit ortodoks me nacionalitetin, Venizelos përdori në mënyrë të qëllimtë statistikën e regjistrimit turk të Shqipërisë së vitit 1908, të përgatitura nën drejtimin e Vezirit të Madh, Hilmi Pasha, sipas të cilave, shumica e popullsisë së këtyre hapësirave ishte e krishterë ortodokse, e për rrjedhojë e gabimit të tij pikasës, edhe greke. Mirëpo, pushtuesit otomanë nuk kishin bërë asnjëherë dallim në mes gjuhës dhe nacionalitetit për nënshtetasit e perandorisë dhe ndarjet brenda këtij shteti bazoheshin në besimin fetar, ku në rastin tonë më të “padallueshmit” kanë qenë shqiptarët e besimit ortodoks, të cilët klasifikoheshin në këtë mënyrë vetëm si grekë. Në bazë të këtyre statistikave, ortodoksët e ritit grek të Shqipërisë së Jugut ishin përfshirë të gjithë në kategorinë e nacionalitetit grek, pa marrë parasysh këtu nëse ata ishin greqishtfolës, shqipfolës, apo vllahishtfolës⁶. Pra, këto statistika

⁶ L. Sigalos, *The Greek claims on Northern Epirus...*, f. 11. Për historinë e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë në periudhën e marrë në studim mund t’i referoheni edhe: Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë, 1913-1914*, Tiranë: UET Press, 2011; Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj, Shqipëria dhe Greqia 1912-1914*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2012; Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi*

ishin të pandershme për shqiptarët, duke qenë se një pjesë e madhe e popullsisë albanofone ortodokse, me ose pa dëshirë, ishte klasifikuar si greke. D.m.th., kyçi i kuptimit të saktë të realitetit etnik në Shqipërinë e Jugut në tërësi mbetej popullsia ortodokse shqiptare e përfshirë gabimisht brenda grekofonisë. Saktësimi i nacionalitetit të kësaj popullsie ishte një faktor përcaktues në vlerësimin e realitetit etnik dhe historik.

Më 15 qershor 1913, dy javë pas nënshkrimit të Traktatit të Londrës, ministri i Jashtëm i Greqisë, Coromilas, ofroi një propozim të veçantë në Konferencën e Ambasadorëve: duke qenë se Italia nuk do ta lejonte Greqinë të vihej në zotërim të bregdetit të Shqipërisë së Jugut (Epirit të Veriut) në veri të Kepit Stillos, ai pranoi që kufiri të niste nga Kepi Stillos, duke ia lënë një rrip bregdeti Shqipërisë, por, kufiri më pas duhej të linte në territorin grek, Gjirokastrën, Përmetin dhe Korçën⁷, d.m.th., qeveria greke po bënte një përpjekje tjetër për të shmangur, në një formë të dëshpëruar, zbatimin e vendimit të Fuqive të Mëdha.

Vendimi përfundimtar i Konferencës së Ambasadorëve është akti i datës 29 korrik 1913, më themelori në pikëpamje të njohjes së Pavarësisë së Shqipërisë. Fuqitë e Mëdha vendosën formimin e “një principate sovraane të trashëgueshme dhe neutrale, nën garancinë e Fuqive”. Në këtë mënyrë, pas lindjes së vështirë të Vlorës më 28 nëntor 1912, ky ishte pagëzimi zyrtar i njohur ndërkombëtarisht i shtetit shqiptar. Pas diskutimesh të gjata, Fuqitë e Mëdha ranë në një mendje mes tyre të pranonin ndërtimin e një komisioni për përcaktimin e kufirit jugor të Shqipërisë. Ka qenë ministri i Jashtëm francez Stephen Pichon, që i propozoi ministrit të Jashtëm italian Tommaso Tittoni, që dy fuqitë e Adriatikut, Italia dhe Austro-Hungaria, duhej ta pranonin komisionin e mësipërm, duke lënë brenda Shqipërisë, Gjirokastrën dhe Korçën. Pas vendimit historik të 29 korrikut 1913, vendimi i tretë më i rëndësishëm, ka qenë vendimi i datës 11/12 gusht 1913. Këtë ditë, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që kufiri midis Shqipërisë dhe Greqisë duhej që të kalonte nga liqeni i Ohrit në kufirin më lindor të ish kazasë turke të Korçës dhe do të shtrihej drejt në bregdet deri në Gjirin e Ftelias, në një pikë në jug të Kepit Stillos (përkundrejt Korfuzit). Kjo shtrirje do të përfshinte brenda Shqipërisë qytetet e Korçës, Tepelenës, Gjirokastrës

kombëtar në Shqipëri, 1912-1924, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013.

⁷ PRO.FO.371.1999, doc.no.24133/128, Greece, Raporti vjetor, 1913. Sër. F. Elliot për Sër Edward Grey, Athinë, 20 maj 1914.

dhe Delvinës, Manastirin e Shën Naumit dhe ishullin e Sazanit. Gjithashtu në këtë marrëveshje u caktua që krahina e Çamërisë duhej t'i kalonte Greqisë, pavarësisht se ajo krahinë ishte e banuar me popullsi shqiptare myslimane (50 000) dhe ortodokse (14 000).⁸ Në shtesë të këtij vendimi u vendos që kanali i Korfuzit duhej të asnjansohej. (Çështja e pjesës bregdetare ka qenë një problem i trajtuar esencialisht në mes Italisë dhe Francës. Italianët kanë kundërshtuar që grekët të vendosnin kufirin e tyre në veri të Korfuzit, mbasi frikësoheshin se kontrolli i të dyja anëve të kanalit prej një fuqie të vetme, do të përbënte një kërcënim për sigurinë e Italisë në Adriatik). Shtrirja e tokës së brendshme në hapësirën në kontestim midis Shqipërisë së sapoformuar dhe Mbretërisë së Greqisë, në bazë të këtij vendimi, do të duhej të përkufizohej brenda katër muajsh, prej një Komisioni Ndërkombëtar të Kufirit, të përbërë nga gjashtë ekspertë të caktuar prej Fuqive të Mëdha. Linja do të duhej të caktohej në terren prej komisionit dhe do të duhej të ishte një kompromis midis kufirit të pretenduar nga Greqia (në anë të së cilës qëndronte e patundur Franca) dhe atij të mbrojtur prej Italisë dhe Austro-Hungarisë. Komisionerët, në përcaktimin e kufirit do të duhej të bazoheshin në karakteristikat etnografike të hapësirave të kontestuara, mbi bazën e ndjenjave të banorëve dhe gjuhës së folur të popullsisë. Gjuha amtare duhej të përcaktohej e sqarohej mirë nga gjuha e folur në rrethet familjare.

Ashtu siç e parashikonin patriotët shqiptarë, qeveria mbretërore greke do të mbetej e pakënaqur nga ky vendim i Konferencës së Ambasadorëve. Ajo vërtet kishte arritur objektivin e parë, atë të përfshirjes së Janinës në Greqi, por kishte aspiruar dhe aspironte edhe Korçën e Gjirokastrën. Ky vend, pas këtij momenti, i drejtuar nga një prej diplomatëve dhe shtetarëve më të aftë të kësaj kohe në Ballkan, Elefterios Venizelos, nëpërmjet një pune këmbëngulëse, arriti të ndryshojë taktikën për realizimin e objektivave të veta dhe vuri në veprim bandat e armatosura të vetëquajtura epirote, që ishin në më të shumtën e rasteve të

⁸ Eqrem Bej Vlora, *Kujtime, 1885-1925*, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 325. Edith Durham, jep të dhëna të tjera. Ajo shkruan në një raport të saj: "Nuk duhet të harrohet se përtej Kepit Stylos, ka mbi 100000 shqiptarë (për të qenë e saktë 130000), të cilët janë shkëputur nga atdheu mëmë, pa përmendur ata që iu dorëzuan Serbisë- mbi një milion". Mary Edith Durham, *Albania and the Albanians, Selected articles and Letters 1903-1944*, Edited by Bejtullah Destani, Centre for Albanian Studies, London: 2001, f. 34.

përbëra nga pjesëtarë të ushtrisë së rregullt mbretërore. Nëpërmjet aktivitetit edhe kriminal të këtyre bandave, Venizelos-i synonte t'u bënte presion Fuqive për ndryshimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve mbi vijën kufitare, duke i vënë Fuqitë para fakteve të kryera. Mund të themi se kjo taktikë politike dhe ushtarake e Greqisë nuk mbeti pa dhënë rezultatet e veta në ndryshimet edhe të vogla të linjave themelore të brendshme të vendosura në terren në kufirin shqiptaro-grek.

*Veprimtaria e Komisionit të Caktimit të Kufirit
në vitin 1913*

Komisioni i Caktimit të Kufirit të Shqipërisë së Jugut e filloi punën më 23 shtator 1913. Komisioni përbëhej nga delegati gjerman, ushtaraku C.Thierry, delegati austro-hungarez Bilinsky (pas vdekjes së papritur të tij më datë 17 nëntor 1913, do të zëvendësohej nga zëvendëskonsulli C. Buchberger), delegatët francezë leutenant koloneli A. Lallemand dhe konsulli M. Gruillet si asistent, delegat i Britanisë së Madhe, Doughty-Wylie, leitnant kolonel, delegati italian N. Labia, konsull, dhe ushtaraku kapiteni M. Castoldi, si dhe në fund delegati rus, koloneli P. Goudime Levkovich.⁹

Më 17 dhjetor 1913, në mbledhjen e fundit të zhvilluar në Firence, komisioni mori vendimin final dhe përpiloi hartën përfundimtare, që u nënshkrua më datë 18 dhjetor 1913. Sipas vendimit të datës 17 dhjetor, i cili la pa saktësuar në letër kufirin lindor dhe juglindor të ish kazasë së Korçës, kufiri i Shqipërisë së Jugut përshtrohet si më poshtë: «*Vija kufitare fillon nga pika C (në hartën austriake, kuota 1738, veri lindje e Mandra Nikolika) ku vija kufitare meridionale e Kazasë së Korçës bashkohet me kreshtën e Gramozit. Ajo vazhdon drejt jugut, duke ndjekur kreshtën e Gramozit deri në Mavri Petra. Më pas kalon nga kuotat 2536 dhe 2019 dhe arrin në Golo. Që andej, pasi ndjek ndarjen e ujërave deri në kuotën 1740, kalon midis fshatrave Radati dhe Kursaka. I drejtohet kodrës që gjendet në veri-lindje të Kukesit, nga ku zbret për të kaluar në Sarandoporos. Vazhdon përgjatë shtratit të këtij lumi deri në bashkimin e tij me lumin Vjosa, prej nga ai arrin në majën e malit Tumba duke kaluar nëpërmjet fshatrave të Zipaliçës dhe Mesarias dhe nëpër kuotat 1956 dhe*

⁹ PRO.FO. 421.287, doc. no. 46121. Nënkoloneli Doughty-Wylie për sër Edward Grey, Manastir, 2 tetor 1913.

2000. Nga maja e malit Tumba, vija kufitare drejtohet drejt perëndimit mbi kuotën 1621, duke kaluar në veri të Zrimasës. Më pas ndjek ndarjen e ujërave deri në lartësinë, që gjendet në veri-lindje të fshatit Episkopi (Peshkëpi) (sipas treguesit të hartës). Që andej drejtohet drejt jugut, duke u mbështetur mbi kreshtën e midis Radatit që i mbetet Shqipërisë dhe Gajdohorit i cili i mbetet Greqisë; më pas vija zbret në luginën Zrinos dhe duke përshkruar lumin, ngjitet mbi kodrën e Kakavisë që është një fshat, i cili i mbetet Shqipërisë. Vija kufitare ndjek përsëri nga ndarja e ujërave, duke i lënë kështu Valtistën dhe Kastanian-in Greqisë dhe Koshovic-ën Shqipërisë, si duke u bashkuar me Murganën, kuota 2124. Prej andej vija kufitare arrin në Stugarë e pastaj në Vertrop, si dhe kuotën 750 duke ia lënë Janjarin dhe Vervën Shqipërisë, kalon nga kuotat 1014, 675, 830 dhe drejtohet në veri-perëndim. Ia lë Konispolin Shqipërisë, ndjek kreshtën e kodrave Stilo dhe Orba, dhe para mbërritjes në kuotën 254 vazhdon drejt jugut dhe bashkohet me gjirin e Ftelia-s».¹⁰

Me Protokollin e Firences, Shqipëria arriti të ruante brenda kufirit të saj shtetëror pjesën më të madhe të krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës, por në mënyrë të paarsyetuar, një pjesë e rrugës së vetme të komunikacionit në mes Shqipërisë Juglindore dhe asaj Jugore, respektivisht Sarandës, u la brenda kufirit grek.

Megjithëse komisioni kishte përcaktuar karakterin e mirëfilltë shqiptar të popullsisë së territorit që u përcaktua për t'iu dhënë Shqipërisë, Mbretëria e Greqisë nuk pranoi të hiqte dorë nga pretendimet e saj për Korçën, Përmetin dhe Gjirokastrën. Që nga ky moment, në qarqet më ekstremiste të Athinës, është marrë vendimi për të ndryshuar taktikë dhe për t'i marrë këto territore edhe me mjete të tjera. Raporte nga Athina që vinin menjëherë sapo ishte marrë vesh pak a shumë cila do të ishte vija kufitare mes dy vendeve në fillimet e dhjetorit 1913, tregojnë se Mbreti Kostandin kishte kërcënuar me shkarkim Kryeministrin Venizelos, në qoftë se ky i fundit dhe qeveria e tij nuk do të mbështesnin ato çarë ai i konsideronte “përpjekjet e popullsisë vendase kundër përfshirjes në Shqipëri”.¹¹

¹⁰ PRO.FO 421.287, doc. no. 57755, f. 273. Shtojcë në nr. 505, Seanca e pesëmbëdhjetë e Komisionit Ndërkombëtar për Caktimin e Kufirit Jugor të Shqipërisë, 17 dhjetor 1913.

¹¹ PRO.FO.371.1804, doc.no. 56641. Sër F. Elliot për sër Edward Grey, Athinë, 10 dhjetor 1913





PRO.FO/ 88110355x

Neutralizimi i Kanalit të Korfuzit, ka qenë një prej çështjeve që është diskutuar në vijim të vendimit të 17 dhjetorit 1913, të arritur në Firence për kufirin tokësor mes Shqipërisë dhe Greqisë. Është një përpjekje për të përcaktuar të drejtën në Kanalin e Korfuzit dhe në përgjithësi në pjesën e kontaktit detar midis Shqipërisë dhe Greqisë në fund të vitit 1913 dhe gjatë shtatë muajve të parë të vitit 1914. Gjegjësisht me metodën e këtij shqyrtimi merret ajo ndarje e të drejtës ndërkombëtare që njihet si e drejta e detit, e cila si shkencë është zhvilluar dhe përpunuar vonë, dhe në kohën në të cilën ne po trajtojmë, kjo e drejtë bënte dallim vetëm në dy ndarje: në *ujërat territoriale* që formonin pjesë të territorit të shtetit, por brenda të cilave shtetet e tjera gëzonin një numër të kufizuar të drejtash, dhe *deti i hapur*, hapësirë detare kjo e lirë për përdorim prej të gjitha shteteve. Ballafaqimi i parë mes fuqive ka qenë i lidhur me kufirin e mbajtjes së ujërave territoriale të Greqisë, që zotëronte ishujt Jonianë. Ruajtja e ujërave territoriale të Greqisë në largësinë deri 3 milje detare, e kërkuar me forcë nga Austro-Hungaria dhe Italia, vërtetë synonte të përcaktonte të drejtat e shtetit grek në hapësirën përkatëse në detin Jon, por duhet të kujtojmë se ky kufizim synonte të zgjeronte hapësirën e nevojshme për ujëra territoriale për entitetin e ri ballkanik, Principatën Shqiptare, të pavarur dhe asnjëse nën garancinë e Fuqive të Mëdha, dhe të krijonte njëkohësisht elementet e nevojshme të sigurisë në këto anë. A kishte një bazë ligjore ndërkombëtare një kërkesë e tillë prej palës austro-italiane? Kërkesa austro-italiane ishte e bazuar mbi një të drejtë që vinte nga shek. XVII, të përpunuar në fillim të shek. XVIII nga juristi holandez Bynkershoek, saktësisht e quajtur *Cannon –Shot Rule* (rregulli i largësisë së të shtënës me top), në bazë të së cilës një shtet e ushtron sovranitetin territorial të pjesës së vet bregdetare brenda tri miljeve. Ky përcaktim rridhte nga fakti se në shek. XVII ky kufi korrespondonte me rrezën e jashtme të armëve të artillerisë bregdetare dhe për këtë pasqyronte parimin se zotërimi i tokës përfundon aty ku përfundon rrezja e armëve (*terrae dominum finitur, ubi finitur armorium vis*). Rregulla nuk ndërtonte një rrip të vazhdueshëm ujërash, por vetëm ndërtonte zona ose “xhepa” detare ngjitur me tokën, në të cilat, gjatë luftërave nuk mund të merrej plaçkë, pa dhunuar një detyrim ndaj shtetit neutral. Doktrina e një rripi të vazhdueshëm të ujërave territoriale, e përbërë prej një gjerësie tri miljesh detare, ose një *league* është formuluar për herë të parë në mënyrë të qartë në vitin 1782, në deklaratën e formuluar nga studiuesi italian Galiani,

ndërsa pranimi i parë i saj në praktikën shtetërore ndodhi në vitin 1793, kur SHBA, të detyruara të përcaktojnë ujërat e veta territoriale në luftën midis Francës dhe Britanisë së Madhe, propozuan që vendet ndërluftuese duhej të respektonin asnjësinë e SHBA deri në maksimumin e rrezes së një predhe topi, zakonisht e llogaritur në tri milje detare, ose një *league*. Kjo përbënte gjerësinë më të vogël të pretenduar nga një shtet.¹² Ky rregull sot nuk njihet nga shumë shtete, por në kohën për të cilën po flasim dhe deri në fund të tri dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XX, ka qenë gjerësisht i njohur dhe i përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare e ndan detin në zona të ndryshme në të cilat shtetet gëzojnë një varietet të kompetencave juridiksionale. Rregulli bazë është se shtetet bregdetare e ushtrojnë shkallën më të madhe të kompetencës juridike mbi atë zonë që shtrihet më afër bregdetit. Pra, një shtet ushtron pushtete të plota të sovranitetit territorial brenda hapësirave ujore, të cilat konsiderohen ujëra të brendshëm, që zakonisht përfshijnë lumenjtë, liqenet dhe gjithashtu portet e hapësirat e tjera detare, të cilat janë të drejtuara me pamje nga toka dhe përbëjnë linjën bazore matëse nga e cila zonat e ndryshme të juridiksionit nga ana e detit janë përgjithësisht të matshme. Në vitin 1914 nuk kanë ekzistuar rregulla bazorë të detajuara dhe të shkruara për përcaktimin e linjave themelore (rregullat e detajuara janë përcaktuar më 1958 me anë të *TCS-First United Nations Law of the Sea Conference* dhe janë rishikuar më 1982 më *LOSC-Convention on the Law of the Sea*), por kanë ekzistuar norma zakonore të pashkruara ndërkombëtare, të cilat shtetet përpiqeshin t'i respektonin (madje, edhe rregullat e shkruara më 1958 dhe 1982 në fakt do të përsërisnin dhe do të përpunonin pikërisht rregullat zakonore ndërkombëtare).

Rasti i përcaktimit të vijës bazë të matshme midis pjesës ishullore greke të ishujve të Jonit dhe bregdetit të Principatës Shqiptare në fakt paraqiste vështirësi për shkak se ishujt kryesorë jonianë (Korfuzi më së shumti në rastin tonë) janë të qarkuar, jo vetëm nga ishuj më të vegjël të banuar, por edhe nga shkëmbinj ujorë, të cilët nuk përmbajnë as jetë humane, as aktivitet ekonomik. Ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë sa e drejta e detit më 1914 mund të ndihmonte në vendosjen e një vije ndarëse të drejtë në Kanalin e Korfuzit dhe në pjesën veriore të ishullit të

¹² Lori Fisler Damrosch, Louis Henkin, Richard Crawford Pugh, Oscar Schachter, Hans Smit, *International Law, Cases and Materials*, Fourth Edition, St. Paul, Minnesota, 2001, f. 1392-1393.

Korfuzit, por sot, neni 121 paragrafi 3 i *Convention on the Law of the Sea* i vitit 1982 e përcakton krejt qartë se, ishujt gjithashtu gjenerojnë zonë detare, *pavarësisht se ekziston një përjashtim i rëndësishëm në rastin e shkëmbinjve ujorë, të cilët nuk përmbajnë jetë humane ose jetë ekonomike brenda tyre e për rrjedhojë ata nuk mund të përbëjnë një arsye për të filluar aty matjen e zonës së ujërave territoriale ose të shelfit kontinental*. Gjithashtu, neni 5 i Konventës së lartpërmendur e ka të përcaktuar qartë se linja ndarëse normale për matjet e gjerësisë së ujërave territoriale është *low-water line* përgjatë bregut të detit, siç tregohet prej simboleve të përshtatshme mbi një hartë të njohur zyrtarisht për shtetin bregdetar.¹³ Dokumentet në National Archives në Londër, nuk tregojnë se në vitin 1914, kur u trajtua ndërkombëtarisht çështja e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë, të jetë bërë ndonjë përpjekje e mëtejshme për vijën ndarëse mes Shqipërisë dhe Greqisë në Kanalin e Korfuzit. Por, në dy nga hartat e katër vilajeteve ku shtriheshin tokat shqiptare në prag të Pavarësisë, të ndërtuara nga një prej institucioneve më prestigjioze të gjeografisë, Institutit të Gjeografisë Ushtarake të Romës (dhe ajo austriake e Institutit Gjeografik Militarë, 1:300000)¹⁴ tregojnë një vijë ndarëse shumë të qartë në Kanalin e Korfuzit, të cilën shtetet e kanë respektuar deri më sot, që vijon qartësisht si në pjesën veriore ashtu edhe në pjesën jugore, dhe që bashkohet me pjesën kontinentale, duke kaluar përmes ngushticës së Prevezës në P. Skile, diku në mes të Gjirit të Artës ose të Ambrakisë.¹⁵ Thënë shkoqur: *vija ndarëse kufitare në Kanalin e Korfuzit ndiqte në mënyrë të barazlartuar, edhe në pjesën veriore, mesin e artë, në mes Ishullit të Korfuzit dhe Bregut shqiptar, pa llogaritur ishujt e vegjël në veri të Korfuzit (Ereikoussa, Othonoi, Mathraki) dhe aq më pak shkëmbinjtë ujorë*.

E lidhur ngushtësisht me përcaktimin e ujërave territoriale të Greqisë dhe Shqipërisë në këto anë, ka qenë edhe përpjekja për neutralizimin (d.m.th. edhe demilitarizimin) e dyfishtë të pjesës tokësore në kufirin e 6 miljeve detare, që ishte një përpjekje për t'i dhënë sigurinë e nevojshme, para së gjithash Principatës së Shqipërisë. Këtë siguri

¹³ Malcolm D Evans, "The Law of the Sea", marrë nga libri: *International Law*, Second Edition, edited by Malcolm D Evans, Oxford University Press, Second Edition, 2006, f. 625-626.

¹⁴ PRO.FO.925.21033.

¹⁵ PRO.FO.925.21007.

shtetit të ri shqiptar kërkonte t'ia jepte protektori austriak, krijuesi e mbrojtësi i shtetit shqiptar (1912-1918).

Pjesët e fundit të projekteve të paraqitura më sipër përpiqen të gjitha të rregullojnë në një mënyrë sa më të përshtatshme për interesat e secilës fuqi, të drejtat e *innocent passage*, d.m.th. kalimit joofensiv të anijeve në Kanalin e Korfuzit.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore ndërpreu të gjitha përpjekjet për përmylljen e traktatit të asnjansimit të Kanalit të Korfuzit në mes Fuqive të Mëdha të asaj kohe. Por mosarritja e këtij rinovimi dhe këtij saktësimi të ri të së drejtës së detit në brigjet Joniane më 1914, nuk do të thotë se e drejta pararendëse u shua tërësisht. Ajo mbeti në fuqi, e sanksionuar në një seri traktatesh dhe mjaftueshëm sa të konsiderohet dhunim i të drejtës ndërkombëtare çdo ndryshim i njëanshëm i metodologjisë punuese për zyrtarizimin e vijës ndarëse, që në një kohë ishte arritur për Kanalin e Korfuzit: 1. Baraslargësia mes bregdetit shqiptar dhe ishullit të Korfuzit edhe në pjesën veriore, aty ku Kanali i Korfuzit lidhet natyrisht me Kanalin e Otrantos; 2. Linja ndarëse normale për matjet e gjerësisë së ujërave territoriale është *low-water line* përgjatë bregut të detit; 3. Shkëmbinjtë ujorë, nuk mund të përbëjnë një arsye për të filluar matjen e zonës së ujërave territoriale ose të shelfit kontinental; 4. Parimet mbi bazën e të cilave, nga viti 1913 është rakorduar njohja reciproke e kufirit detar në mes Shqipërisë dhe Greqisë në Kanalin e Korfuzit, posaçërisht në pjesën e pjerrët, përbëjnë një precedent që nuk mund të ndryshohet njëanshmërisht në vitin 2020, por veç mund të zgjidhet gjyqësisht. Kjo e fundit do të thotë se në pjesë veriore dhe veriperëndimorë të Kanalit, pretendimi i Shqipërisë zyrtare është se matjet duhet të fillojnë nga Korfuzi dhe nga Bregu e Karaburuni dhe jo nga ishujt e vegjël veriorë, sikurse po tentohet të impostohet diskutimi.

2. Çështja e kufirit pas Luftës së Parë Botërore (1918-1926)


Fillimi i Luftës së Parë Botërore ndërpreu të gjitha përpjekjet për përmylljen e Traktatit të Neutralizimit të Kanalit të Korfuzit midis Fuqive. Përfundimi i Luftës rinxori edhe një herë në skenën e trajtimit diplomatik çështjen e statusit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe të kufijve të saj shtetërorë. Për tre vite me radhë Fuqitë fituese të Antantës, të çliruara tashmë nga rezistenca e Austro-Hungarisë, të dezintegruar si

shtet, u përpoqën të kthenin skemat e pretenduara prej tyre në kohën e Luftërave Ballkanike. Falë ndërhyrjes energjike të Presidentit amerikan Woodrow Wilson, shteti shqiptar u ruajt afërsisht në kufijtë e vitit 1913. Më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve në Paris, nën kryesinë e M. Jules Cambon-it, procedoi me firmosjen e vendimit për sa i përket Shqipërisë: Perandoria Britanike, Franca, Italia dhe Japonia, konfirmuan projektin e kufijve të Shqipërisë, të njëjtë me atë që ishte vendosur më 1913 në Konferencën e Ambasadorëve. Duke qenë se kufijtë jugorë ishin vendosur në terren nga Komisioni i Caktimit të Kufijve, përmes një protokollit përfundimtar në Firence më 17 dhjetor 1913, dhe duke qenë se Komisionit të Caktimit të Kufijve Veriorë dhe Lindorë i ishte dashur të ndërpriste punën e tij më 1914 për shkak të operacioneve luftarake, Konferenca mori këtë vendim: 1. Qeveritë nënshkruese njihnin qeverinë e Shqipërisë të ndërtuar nga shteti sovran e i pavarur. 2. Një komision i përbërë nga 4 anëtarë, të emëruar nga qeveritë nënshkruese të këtij vendimi, ngarkohej, të caktonte në terren vijën kufitare veriore dhe verilindore të Shqipërisë. D.m.th. kufiri mes Shqipërisë dhe Greqisë konsiderohej ai që ishte vendosur nga Protokollit i Firences.

Me gjithë këto përcaktime, edhe në periudhën vijuese, marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë vazhduan të jenë të vështira, mbasi qeveria e Athinës nuk njohu plotësisht kufijtë e vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve dhe të drejtat e Shqipërisë mbi rajonin që nga Greqia thirrej si Epiri i Veriut.

Si vështirësi kryesore paraqitej kufiri greko-shqiptar në zonën e Korçës, mbasi komisioni i para luftës nuk e kishte caktuar në terren në vitin 1913. Bëhet fjalë për një segment të vogël në zonën e fshatrave të liqenit të Prespës, pikërisht për fshatrat e minoritetit maqedonas, të gjitha në linjën nga fshatrat Zagradec, Vrnica, Kapshticë, Trestinik, Novoselo deri në Slimnica, të cilat qeveria shqiptare i konsideronte pjesë të ish kazasë otomane të Korçës dhe për rrjedhojë, parimisht, duhet të ishin pjesë e Shqipërisë. Ky diskutim zhvillohej ndërkohë që ushtria greke nuk ishte tërhequr nga një pjesë e rëndësishme e këtyre fshatrave. Komisioni verifikoi edhe *Turkish Yearbook*, i cili saktësonte emrat e fshatrave dhe krahinave të cilat ishin përfshirë në regjistrin e mbledhjes së taksave. Sipas këtij libri, 26 fshatra të listuara këtu ishin pjesë e kazasë së Korçës, por tani mbaheshin të pushtuara prej trupave greke. Kësisoj, Komisioni i sugjeroi Lidhjes së Kombeve, formimin e një tjetër komisioni ekspertësh, që do të shkonte në terren për të shënuar në mënyrë përfundimtare kufirin

e kazasë së Korçës, në përputhje me informacionet që zotëroheshin në Stamboll për atë distrikt. Komisioni i Hetimit gjithashtu mendonte që të vendosej edhe një zonë neutrale nga kjo pikë deri në vendin ku kishte përcaktuar Protokollin e Firences si definitive. Kjo zonë neutrale do të duhej të përfshinte fshatrat e pushtuara në këtë kohë nga ushtria greke.¹⁶



Hartë e rajonit të Korçës që tregon propozimin e linjës së kufirit tek 26 fshatra, linjë që duhet të bashkohet me linjën e Protokollit të Korfuzit

¹⁶ PRO.FO.371.7328, Lidhja e Kombeve, Shqipëria, Raport i Komisionit të Hetimit, Jens Meinich, J.J. Sederholm, Tiranë, 18 janar 1922.

E gjendur para vështirësive të ushtrimit të plotë të sovranitetit territorial, më 16 janar 1922, Kryeministri Xhafer Ypi, i kërkoi përfaqësuesit britanik në Durrës, Heathcote, të informonte qeverinë britanike, se kërkesa e Konferencës së Ambasadorëve për evakuimin e të gjithë territorit deri në kufijtë e vitit 1913, nuk kishte marrë ende përgjigje pozitive nga qeveria greke.¹⁷ Ushtria greke në janarin e vitit 1922, ende gjendej në pushtim të 26 fshatrave të ish kazasë së Korçës (Slimnica, Bezmishte, Pilkat, Postec, Trestenik, Rakicka, Rakoha, Zaroshke, Zagradec, Shuec, Shulin, Travova, Grazedan, Glomboc, Gorica, Kapistica, Kostec, Konsko, Labonica e Sipërme, Labonica e Poshtme, Leske, Vrnik, Nivica, Novoselo, Ornovcka, Xerje) të gjithë në zonën e Bilishtit. Mbajtja e këtyre fshatrave bëhej nën arsyetimin e pavërtetë, se këto fshatra asnjëherë nuk kishin qenë pjesë e kazasë së Korçës. Trupat greke ishin lejuar të qëndronin në pushtimin e përkohshëm të këtyre fshatrave nga gjenerali francez, në momentin e ikjes së tij nga Korça. Presioni dhe pushtimi i autoriteteve ushtarake greke vazhdoi gjatë.¹⁸

Problemi i Epirit të Veriut ose i Shqipërisë së Jugut ka vazhduar të jetë një prej problemeve të mprehta të diplomacisë shqiptare. Forcat ekstremiste në Greqi, janë përpjekur ta paraqesin rastin në fjalë si një çështje e drejtësisë dhe e drejtave njerëzore dhe si një çështje që rrezikonte të shpërthente trazira në të ardhmen e jetës së brendshme shqiptare dhe marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë. Në fakt realiteti ka qenë krejt ndryshe, përderisa realiteti etnik nuk përputhej me prezantimin grek.

Në dokumentacionin e kohës bien në sy një seri manipulimesh dhe një numër aktorësh të angazhuar kundër stabilitetit të Shqipërisë dhe synimeve gllabëruese në jug të vendit, të cilët vendosën të gjithë arsenalin propagandistik dhe diplomatik në errësimin e situatës: në radhë të parë kanë qenë katër mitropolitët e Epirit, Basile i Gjirokastrës, Germano i Korçës, Joachim i Kosturit dhe Kolonjës dhe Spiridon i Janinës, të cilët iu drejtuan lordit Rober Cecil, më datë 30 maj 1922 në një letër në mbështetje të aneksimit të këtyre anëve në Greqi¹⁹; së dyti,

¹⁷ PRO.FO.371.7326, C1191/83/90. Heathcote-Smith për markezin Curzon i Kedleston-it, Durrës, 16 janar 1922.

¹⁸ PRO.FO.371.7327 C 6023/83/90. Z. Eyres për markezin Curzon i Kedleston-it, Durrës, 15 prill 1922.

¹⁹ PRO.FO.371.7327 C 7980/83/90, f. 54, 55 dhe 56.

Lidhja e Epirit të Veriut me qendër në Follorinë: Presidenti i kësaj organizate të sajuar, i drejtoi një letër ministrit britanik në Athinë, në lidhje gjoja me persekutimet, deportimet e sforcuara dhe barbarizmat që po pësonte elementi grek në të ashtuquajturin Epiri i Veriut.²⁰ Veçanërisht aktive kanë qenë qarqet ekstremiste pranë Mbretit të Greqisë. Në mes këtyre ndërhyrjeve të bën përshtypje një letër e sekretarit personal të Mbretit Konstandin, drejtuar Kryeministrit britanik Lloyd George.²¹ Pavarësisht gjendjes së brendshme politike mjaft të ndërlikuar të Shqipërisë, Sekretari përpiqet ta errësojë edhe më tej, duke e paraqitur situatën sociale si të rrezikshme për pakicat minoritare greke në vend. Duhet të kemi parasysh se ai konsideronte të tillë edhe popullsinë ortodokse shqiptare. Sipas tij, gjendja shqiptare ishte kaotike ngjashëm me një vend tribal, që kontraston, sipas tij, me nivelin e lartë kulturor të Epirit të Veriut. I gjithë ky përshkrim i hollësishëm përfundonte me kërkesën që ai i drejtonte qeverisë britanike, që kjo e fundit t'i rekomandonte me forcë Këshillit Suprem të Antantës, rikonsiderimin e vendimit lidhur me fatin e Epirit të Veriut.²² Pra, kemi një përpjekje për të ndërhyrë në rishikimin e vendimit të 10 nëntorit 1921, duke e paraqitur si entitet të veçantë dhe strukturalisht jo homogjen Epirin e Veriut në raport me Shqipërinë në tërësi. Kurse Unioni Pan Epirotas në Amerikë, me datën 5 korrik 1922, përmes drejtorit të organizatës, N.J. Cassavitis, i drejtoi një letër Earl Arthur Balfour, ku i shpjegonte “persekutimin e epirotasve, dhunimin e kishave, shkollave dhe institucioneve komunale lokale”, dhe i kërkonte ndaljen e deportimeve dhe shtypjes në përgjithësi prej shqiptarëve.²³ Kjo kërkesë ishte krejtësisht jashtë sensit të realitetit të gjërave, por bëhej në një moment koordinimi për politikën greke ndaj Shqipërisë. Krijimi i fabulës së persekutimit të minoriteteve dhe vendosja para përgjegjësisë së Fuqive të Mëdha për “gabimin historik”. Memorandumi jo pa synim tërheq vëmendjen për mungesën e mbrojtjes ndaj minoritarëve grekë në Shqipëri nga ana e Lidhjes së Kombeve, dhe përpiqet të denoncojë ato që ai i konsideron, “raporte jo korrekte të bëra

²⁰ PRO.FO.371.7327 C 6188/83/90, dhe C94/83/90 f. 80, 81, 83, 84, 85, 86.

²¹ PRO.FO.371.7330, f. 46. G. Melas, ish Sekretar i Madhërisë së Tij, Mbretit Constantine për Fort të Nderuarin David Lloyd George, St. James' Street, S.W.1, 11 janar 1922.

²² Po aty.

²³ PRO.FO.371.7327 C10418/83/90. N.J. Cassavitis për kontin Arthur James Balfour, Filadelfia, 5 korrik 1922.

prej Komisionit të Hetimit në Shqipëri”. Memorandumi pretendon se pjesa më e madhe e popullsisë së Korçës është progreke për sa i përket simpative, kërkon vendosjen e epirotasve nën kontrollin e Fuqive të Mëdha dhe i bën thirrje Greqisë se duhet të mbrojë autonominë e kësaj ane (Epirit të Veriut).

Pas këtij presioni politik të qarqeve shoviniste joqeveritare, ofensiva diplomatike greke kaloi në një stad tjetër të veprimit taktik, zbatimin e fazës së parë të planit të gatuar para Luftës: përmes legatës greke në Paris, qeveria drejtoi dy nota: njëra më datë 5 qershor 1922 dhe tjetra më 16 qershor 1922, adresuar në Konferencën e Ambasadorëve. Thelbi i tyre ishte se Konferenca duhej të impononte zbatimin e Protokollit të Korfuzit të datës 17 maj 1914, mbi autonominë e Vorio-Epirit.²⁴ Pra, kemi të bëjmë me një lëvizje që synonte artificialisht kthimin mbrapa në kohë, kur andartët bënë kërkinë në Jug të Shqipërisë dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit në vitin 1914 u detyrua të bënte pakt me banditët e Zografosit dhe Karapanos, si një mënyrë për të neutralizuar goditjet ndaj Principatës së brishtë së Shqipërisë së drejtuar nga Mbreti legjitim Wied. Kësaj ofensive, Kryetari i delegacionit shqiptar në Paris, Dhimitër Berati, iu kundërpërgjigj me një kundërnote drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, duke hedhur poshtë pretendimet greke, gjoja mbi persekutimet e të krishterëve në Shqipëri dhe në këmbim, madje u ankua mbi shtypjen e egër të shqiptarëve të krahinës së Çamërisë nga ana e autoriteteve greke dhe në territoret brenda kufijve shqiptarë, ku forcat greke ende nuk ishin evakuuar²⁵.

Për fat të mirë, Fuqitë e Antantës operonin me një minimum arsyeje dhe nuk mund të rivlerësonin dhe ligjësonin, akte ndërkombëtare ose dypalëshe, që zhvillimet e luftës dhe aktet e Konferencës së Paqes i kishin shfuqizuar. Ministri i Jashtëm britanik Earl of Balfour, e konsideroi Protokollin e Korfuzit, jo më një instrument të vlefshëm. Së pari, sipas tij, të ashtuquajturit epirotas (kupto: paramilitarët, andartët - R.G.) vetë e dhunuan këtë marrëveshje, duke pushtuar Korçën në korrik të vitit 1914; së dyti, kjo marrëveshje ishte kapërcyer nga një seri aktesh pasardhëse dhe mbi të gjitha nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të datës 9 nëntor 1921; së treti, grekët vetë, kur menduan

²⁴ PRO.FO.371.7327 C 9405/83/90. Sër Milne Cheetham për kontin Balfour, Paris, 1 korrik 1922.

²⁵ PRO.FO.371.7327 C 9518/83/90. Lord Hardings për kontin Balfour, Paris, 3 korrik 1922.

se Epiri i Jugut mund t'i kalonte Greqisë gjatë tratativave të vitit 1919 dhe 1920, asnjëherë nuk e përmendën ekzistencën e një protokollit të tillë. Së fundmi, për sekretarin e Jashtëm britanik, çështja e mbrojtjes së popullsisë minoritare greke në Shqipërinë e Jugut ishte tashmë çështje e Lidhjes së Kombeve. Në fund, këtë pikëpamje Britania e Madhe e mbrojti edhe në Konferencën e Ambasadorëve, duke i mbyllur rrugët e ndërhyrjes greke sërish në çështjet e brendshme të Shqipërisë.²⁶ Në shenjë proteste për mbylljen e diskutimit mbi përdorimin e Protokollit të Korfuzit, si mjet për të ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë, delegacioni grek në Komisionin e Kufirit të Shqipërisë, pasi dështoi të merrte konsensusin e komisionit për zbatimin e menjëhershëm të Protokollit, u largua nga Shqipëria. Kemi të bëjmë me një përpjekje sistematike për të penguar sa më shumë fillimin e punës në terren. Mirëpo, pikërisht në këto momente, qeveria e SHBA njohu qeverinë e Shqipërisë. Njohja amerikane ishte një goditje e rëndë për të gjitha pretendimet e Greqisë dhe u imponoi autoriteteve qeveritare greke, së paku, ruajtjen e fasadës së një vendi serioz. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, rreth datës 12 korrik 1922, edhe qeveria greke njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare se e njohte atë si *de jure* qeveri të Shqipërisë. Kjo njohje në fakt u shoqërua edhe me një protestë rreth kufirit jugor.²⁷ Ministër i Greqisë në Shqipëri, me seli në Durrës u caktua Nakos Panourgias, ish këshilltar i legatës greke në Sofje. U krijua kështu një situatë paradoksale: qeveria greke e njohte ekzistencën e shtetit shqiptar, por pengonte zbatimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve për vendosjen në funksion të Komisionit të Kufirit.

Kjo i detyroi Fuqitë e Mëdha të ndërmarrin lëvizjen tjetër diplomatike. Më 7 shtator 1922, ministrat e Francës, Italisë dhe Britanisë së Madhe në Athinë, i bënë një vizitë të përbashkët ministrit grek të Punëve të Jashtme M. Baltazzi. Ndër të tjera, ata i shpjeguan kryediplomatit grek, pozitën e vështirë të krijuar në Komisionit e Caktimit të Kufirit Greko - Shqiptar nga veprimi i delegatit grek dhe i kujtuan atij, se Protokollit i Korfuzit ishte pezulluar me kohë prej vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Paris në nëntor të vitit 1921. Përmes gojës së ministrit italian ata i bënë të qartë, se Komisioni i

²⁶ PRO.FO.371.7332, C9439/6727/90. Konti Balfour për lordin Hardinge, F.O., 6 korrik 1922.

²⁷ PRO.FO.371.7331, C10491. Eyres për Balfour-in, Durrës, 12 korrik 1922.

Kufirit, do të duhej ta vazhdonte punën e vet dhe ndaj ishte e këshillueshme që delegati grek duhej të kthehej në Shqipëri, ose dikush tjetër duhej të zinte vendin e lënë vakant nga ai²⁸.

Ndërkohë, situata në jug të Shqipërisë, vazhdonte të ishte e paqartë për një sërë problemesh. Popullsia ortodokse e Shqipërisë së Jugut, e vendosur nën presione dhe në mes të një përballjeje të ftohtë politike dhe nacionaliste, gjendej në pozita pritjeje, e ndrojtur dhe me mungesë kapacitetesh administrative. Mbyllja e kufijve prej autoriteteve greke si presion ndaj Shqipërisë, shkaktoi krizë serioze tregtare në këtë pjesë të vendit që jetonte prej shekujsh në komunikim tregtar me anët përtej. Ndërkaq, çështja e krijimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare u bë kyçi i diskutimeve në vend dhe brenda komunitetit, duke iu bashkangjitur problemeve ekzistuese.

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht rezultateve të Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve dhe raporteve pararendëse diplomatike mbi situacionin etnik, religjioz dhe social në Shqipërinë e Jugut, në diplomacinë perëndimore nuk ka pasur një bindje të konsoliduar mbi realitetin e punëve në vend. Propaganda e qarqeve shoviniste ishte aq intensive, sa linte gjurmët e veta në kuptimin e së vërtetës. Prandaj për të sqaruar situatën, në fillim të muajit gusht 1922, ministri britanik në Durrës, Eyres, ndërmori një udhëtim nëpër krahinat e Shqipërisë së Jugut dhe vizitoi qytetet e Fierit, Vlorës, Gjirokastrës, Delvinës, Korçës Bilishtit, Hoçishtin, Pogradecin dhe Përmetin. Diplomati britanik gjatë vizitës disaditore në Gjirokastrë arriti në përfundimin se një prirje drejt Greqisë ekzistonte kryesisht mes pjesës së vjetër të popullsisë dhe kjo për shkak të një lloj tradite, që ky brez kishte përjetuar nën sundimin otoman, duke e parë Greqinë si shpëtimtarin dhe mbrojtësin e tyre nga osmanët dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas të otomanizuar. Përndryshe, brezi i ri i popullsisë ortodokse shqiptare ishte universalisht një gjeneratë patriotike shqiptare, madje disa prej tyre edhe antigrekë. Pjesa konservatore e popullsisë ortodokse, që e shihte me dyshim shtetin e ri shqiptar dhe bashkëjetesën me popullsinë shqiptare e religjioneve të tjera, sipas përllogaritjeve të ministrit britanik, arrinte afërsisht 10% e popullsisë së krishterë të Shqipërisë së Jugut.²⁹ E gjendur

²⁸ PRO.FO.371.7328, C13141/83/90. Bentinck për markezin Curzon i Kedleston-it, Athinë, 8 shtator 1922.

²⁹ PRO.FO.371.7330, C12535/818/90. Z. Eyres për kontin Balfour, Durrës, 23 gusht 1922.

nën presionet e pushtetit turk për shekuj me radhë dhe nën frikën e një shteti shqiptar që nuk i kishte bërë të qarta ende objektivat e veta qeverisëse gjithëpërfshirëse, popullsia ortodokse shqiptare e kësaj kohe ndjehej e ndrojtur, e frikësuar dhe e pasigurtë për vendosjen e një qeverisjeje kushtetuese dhe të europianizuar në vendin me shumicë myslimane. Kjo, sipas ministrit britanik, e pengonte këtë popullsi, në këto vite të ngjizjes së shtetit dhe bashkësisë qytetare shqiptare, të plotësonte detyrat e veta ndaj shtetit dhe bashkësisë së shtetasve shqiptarë. Gjirokastra, pavarësisht pozicionit të vet strategjik në vend, konsiderohej nga ministri britanik, si një prej vendeve më të prapambetura. Popullsia e kësaj qendre përherë kishte dërguar për t'u shkolluar fëmijët si studentë në shkollat otomane dhe për rrjedhojë, një numër shumë i madh gjirokastritësh kishin shërbyer gjatë periudhës së Perandorisë si kadilerë dhe punonjës të administratës. Njerëzit e kësaj sere në këtë qytet ishin ndoshta pjesa më e prapambetur e popullsisë së Shqipërisë dhe statusi i gruas në këtë qytet ndodhej në gjendjen më të degraduar se ndonjë vend tjetër në Turqi. Pjesa e krishterë e popullsisë së Gjirokastrës ishte mjaft mirë e arsimuar, por ato, në rrethanat e krijuara nën sundimin otoman, nuk kishin arritur të bënin përpara për shkak të pengesave të sistemit. Në pikëpamje ekonomike, tregtia anekënd Shqipërisë së Jugut ndodhej në një situatë krize serioze. Biznesi ishte bllokuar për shkak të mbylljes së kufirit nga ana e qeverisë greke. E vetmja arsye e kësaj bllokade nga ana e qeverisë greke kishte të bënte me synimet e saj për ta vështirësuar jetesën, duke penguar rrugën e forcimit të shtetit të pavarur shqiptar.

Sipas diplomatit britanik, Korça e çmonte veten se është qyteti më modern dhe më përparimtar i Shqipërisë dhe ndoshta pretendimi i saj ishte i justifikuar, megjithëse Shkodra mund të ofrojë përshtypjen se është ajo, për shkak të pozicionit të bukur natyror dhe ndërtesave publike, pararoja e europianizimit në vend. Popullsia ishte mjaft e gjallë e pjesëmarrëse dhe e konsideronte detyrë të çdo qytetari për ta bërë zërin e vet të dëgjohet. Një zhvillim shumë pozitiv këtë kohë në Korçë ishte prania e një numri të madh shqiptaro-amerikanësh.

Problemi kryesor që ngjallte diskutime dhe agjitacione asaj kohe në qytetin e Korçës por jo vetëm, edhe në të gjitha krahinat ortodokse të Shqipërisë së Jugut, ishte problemi i Kishës. Në vetë Korçën ekzistonin tre parti: 1. Partia e vjetër konservatore që dëshironte të ruante lidhjen me Patriarkatin dhe liturgjinë në gjuhën greke; 2. Partia Ekstremiste, që dëshironte të shkëpuste menjëherë çdo lidhje me Patriarkatin, të

themelonte Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe të vendoste në përdorim liturgjinë në gjuhën shqipe; 3. Partia e Moderuar, e cila dëshironte të ndiqeshin metodat e rregullta, përmes negocimit me Patrikanën, me synim arritjen e një marrëveshjeje për themelimin e një Kise Autoqefale dhe vendosjen si gjuhë të liturgjisë, gjuhën shqipe. Personi më i rëndësishëm në drejtimin dhe trajtimin e kësaj çështjeje ishte ipeshkvi Fan Noli, i cili mbështetej nga shqiptaro-amerikanët. Problemi ngrihej në një moment shumë të vështirë për shtetin shqiptar, kur ai nuk ishte ende i konsoliduar dhe ky problem krijoi diskutime të mëdha dhe thyerje zemre brenda popullsisë ortodokse.

Qëndrimi i qeverisë shqiptare ka qenë i matur: ajo e konsideronte çështjen e mësipërme si një çështje vetëm të ortodoksëve shqiptarë, të cilët do të duhet të vendosnin vetë lirisht, duke negociuar këtë çështje me Patrikanën e Konstandinopojës. Përfundimi më i rëndësishëm i udhëtimit të ministrit britanik në Shqipërinë e Jugut, ka të bëjë me nulifikimin e pretendimeve greke. Ai shkruan se

“unë nuk munda të zbuloj asgjë për të justifikuar ankesat e qeverisë greke. që janë dërguar në Lidhjen e Kombeve. Popullsia e fshatrave në krahinat e interesuara ishte krejtësisht në padijeni të të ashtuquajturave praktika të këqija të qeverisë shqiptare dhe përshtypja që unë krijova ishte se këto pretendime dhe akuza ishin jo vetëm shpikje të pastra, por gjithashtu një llogaritje e shtrembëruar e ngjarjeve që unë ju përshkruajta”³⁰.

Po ndërkohë që ndaj Shqipërisë, qeveria greke vazhdonte të ushtronte presion për territoret e Jugut, një veprim gjenocidal ishte në zhvillim e sipër po nga kjo qeveri ndaj popullsisë shqiptare në lindje të Kanalit të Korfuzit, në pjesën që Protokolli i Firences ia kishte lënë Greqisë. Kundër këtyre ndërhyrjeve dhe persekutimeve, ministri shqiptar në Londër, Mehmet Konica, më datë 11 dhjetor 1922, i adresoi një letër sekretarit britanik për Punë të Jashtme, Marquess Curzon of Kedleston. Sipas kësaj ndërhyrjeje, bazuar në komunikimet e prefektit të Korçës dhe në kërkesën e qeverisë shqiptare, ai shprehet se *“autoritetet greke janë të vendosura të ndjekin ndaj shqiptarëve të Çamërisë, të njëjtat taktika sikurse ka ndjekur Qeveria e Ankarasë ndaj grekëve të Azisë së Vogël, me ndryshimin se shqiptarët në territoret e aneksuara nuk u kanë dhënë autoriteteve greke asnjë arsye për një persekutim të tillë”*. Ai u kërkoi

³⁰ Po aty.

autoriteteve britanike që Fuqitë që kishin vendosur të dorëzonin këto territore nën Greqinë, duhet të merrnin përgjegjësinë morale ndaj kësaj popullsie dhe hapat e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe pronave të tyre. Përfaqësuesi i Shqipërisë kërkonte që kjo ndërhyrje të realizohej përmes Konferencës së Ambasadorëve, ose edhe mënyrave të tjera që qeveria britanike do ta konsideronte si të përshtatshme për të ndaluar trajtimin jo human nga ana e qeverisë greke të çamëve.³¹ Popullsia e Çamërisë në këto ditë të vështira të vitit 1922 ndodhej në situatë të dëshpëruar, për shkak të persekutimit dhe veprimeve kriminale nga ana e autoriteteve civile dhe ushtarake greke. Ato ishin nxjerrë me forcë nga shtëpitë dhe nga zotërimet pronësore, rrahur dhe detyruar me forcë që të emigronin. Shtëpitë e tyre ishin pushtuar nga refugjatët grekë, që ishin shkëmbyer me Turqinë nga grekët e Anolisë dhe Trakës. Por, pavarësisht ngjarjeve të mësipërme, Konferenca e Ambasadorëve e Fuqive Aleate vendosi që çështjet e ngritura nga palët greke dhe shqiptare duhet të zgjidheshin drejtpërdrejtë nga dy qeveritë respektive, nëpërmjet kanaleve diplomatike.³² Në morinë e problemeve të pazgjidhura pas Luftës së Parë Botërore, konflikti kompleks greko-shqiptar hynte si një shtojcë e rreshtuar në hiqe rend të dytë për diplomacitë perëndimore. Perëndimorët u mjaftuan vetëm me fiksimin e çështjes së kufirit, por aspak për respektimin reciprok të të drejtave të minoritetit shqiptar, mysliman dhe ortodoks, të lënë në anën greke. Vetë shteti shqiptar ishte mjaft i brishtë dhe me autoritet të paformësuar ndërkombëtar sa të kishte peshën e duhur për një ndikim të vendosur. Për rrjedhojë, standardizimi reciprok i të drejtave të minoriteteve, ruajtja e veçantive kulturore, mbrojtja e të drejtave për arsimin kombëtar dhe religjionet, nuk funksionoi, u mbart në këtë armiqësi edhe për 25 vite të tjera deri në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë nuk ndryshuan edhe në periudhën nga muaji dhjetor 1922 dhe gjatë vitit 1923. Qeveria greke në këtë periudhë vazhdoi t'i përmbahej qëndrimit të mëparshëm të moskonsiderimit të krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës si krahina të Shqipërisë. Banorëve të këtyre krahinave që shkolin në Greqi iu merreshin pasaportat shqiptare dhe zëvendësoheshin me pasaporta greke.

³¹ PRO.FO.371.7332, C 17126. Mehmet Konica drejtuar markezit Curzon të Kedleston-it, Londër, 11 dhjetor 1922.

³² PRO.FO.371.7332, C 17378. Eric Phipps, për markezin Curzon të Kedleston-it, Paris, 18 dhjetor 1922.

Qeveria greke gjithashtu thirri për të kryer shërbimin ushtarak grek, të rinjtë nga Shqipëria e Jugut të moshës 19-23 vjeç, që ishin rezidentë në Greqi. Pra, pavarësisht se Shqipëria dhe Greqia kishin vendosur marrëdhënie diplomatike dhe kishin shkëmbyer ambasadorët gjegjës, Greqia vazhdonte të sillej në mënyrë agresive ndaj Shqipërisë, integritetit të saj dhe shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm në Greqi.³³ Kjo situatë nuk mund të zgjidhej pa një ndërhyrje energjike prej anës së fuqive perëndimore.

Dhe ndërhyrja e Fuqive të Mëdha erdhi, dhe siç duket pati ndikimin e vet rrethues ndaj obstruksionizmit të qeverisë së Greqisë: vendosja e menjëhershme në funksion e Komisionit të Caktimit të Kufirit, do të ndante palët në konflikt dhe do të ndalonte përpjekjet e mëtejshme të Greqisë në Shqipërinë e Jugut. Bazuar në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të datës 9 nëntor 1921, për fiksimin e kufijve të Shqipërisë, u ngrit Komisioni Ndërkombëtar, të cilit iu ngarkua detyra për të vazhduar punën e Komisionit Ndërkombëtar të Caktimit të Kufirit të vitit 1913-1914 dhe për të kryer ndryshimet e përcaktuara nga Konferenca e Ambasadorëve e 9 nëntorit 1921. Në shtesë, përsa i përket kufirit të Shqipërisë me Greqinë, në përputhje me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të datës 1 shkurt 1922, Komisioni i mësipërm u udhëzua të përkufizonte kufirin deri në pikën ku Komisioni i vitit 1913-1914, e kishte përcaktuar me Protokollin e Firences të 17 dhjetorit 1913. Më në fund, Komisioni u mbledh në Paris më 18 shkurt 1923, i përbërë nga: Gjeneral Enrico Tellini, komisioneri italian dhe Kryetar i Komisionit, lt. kolonel Frank Giles, komisioneri britanik, majori Emmanuel Perret, komisioneri francez. Përgjatë punës, përbërja e Komisionit u ndryshua plotësisht. Komisioneri francez u ndryshua sapo filloi puna në vitin 1923; më 27 gusht të vitit 1923, Gjeneral Tellini, së bashku me oficerët e delegacionit italian u vranë në Delvinaki, kështu që delegacioni italian u rindërtua krejtësisht. Së fundi, më 1 maj 1925, koloneli Giles u largua nga Komisioni për shkak se u caktua atashë ushtarak në Beograd, për rrjedhojë, në fund të punimeve të komisionit, përbërja ka qenë si vijon: Gjeneral Pietro Gazzera, komisioner italian dhe kryetar, kolonel Andre Ordioni, komisioner francez, dhe lt. kolonel,

³³ PRO.FO.371.8531 C 7811. Raport i Komisionit të Hetimit mbi punën e tij nga 19 dhjetori 1922 deri më 1 shkurt 1923, Hetimi mbi Shqipërinë Jugore, Gjenevë, 6 prill 1923.

Arthur B. Clough, komisioner britanik. Në shtesë, qeveritë kanë caktuar delegatë për Komisionin: për Shqipërinë kanë qenë një mbas një: Mehdi Bej Frashëri, Hajdar Libohova, Gjeneral Ali Kolonja, Major Bajram Fevzi, M. Berati; sërish Mehdi Bej Frashëri dhe Iliaz Vrioni. Për Greqinë, janë pasuar një mbas një, lt. kolonel Karkandjos, lt. Kolonel Botsaris, lt. Kolonel Christos Avramides.

Përsa i përket kufirit jugor të Shqipërisë, pjesa e kufirit që asnjëherë nuk ishte studiuar në terren ka qenë ajo nga bregu perëndimor i liqenit të Ohrit, deri në malin e Gramozit. Ndërsa pjesa nga mali i Gramozit deri në ngushticën e Korfuzit, ishte përkufizuar dhe shënuar në hartë sipas Protokollit të Firences më 1913, por shënjuet nuk ishin vendosur për të treguar kufirin në terren.

Në vitin 1924, nga muaji maj deri në muajin tetor, u realizua shënjimi i kufirit nga liqeni i Prespës deri në malin e Gramozit dhe kjo u pasua me evakuimin e trupave greke nga territori i Shqipërisë së pushtuar prej tyre. Më pas, nga muaji nëntor i vitit 1924 deri në shkurt 1925, Komisioni u angazhua sërish në Firence, në përshkrimin e Protokollit të Kufirit Greko-Shqiptar (Protokollit i Dytë i Firences). Ndërsa në mes të periudhës nga muaji prill 1925 deri në gusht të vitit 1925, vijuan bisedimet në Paris midis palëve të interesuara, me synim vendosjen e një marrëveshjeje për të gjitha çështjet që mbeteshin pezull për kufirin e shtetit të ri të Shqipërisë.

Duke qenë se bisedimet midis palëve të interesuar përsa i përket aspekteve të ndryshme në një protokoll special nuk patën sukses, Komisioni, në muajin dhjetor 1925, u detyrua t'ia nënshtrojë rastin Konferencës së Ambasadorëve për të marrë vendimin e tyre.

Në muajin korrik 1926, Komisioni u rimblodh dhe mori tekstin final të protokollit në fjalë nga Konferenca e Ambasadorëve. Më 30 korrik 1926, Komisioni mori pjesë në Konferencën e Ambasadorëve në *Quai d'Orsay* në Paris, ku u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të aktit final prej ambasadorëve të të gjitha vendeve dhe prej ministrave të Jashtëm të tre vendeve të interesuar, Greqisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë.³⁴ Përsa i përket kufirit me Greqinë, Konferenca e Ambasadorëve ruajti përcaktimit e Protokollit të Parë të Firences, 17 dhjetor 1913.

³⁴ PRO.FO.371. 11203, C9240/27/90. Caktimi i kufirit të Shqipërisë, Komisioni i Kufirit Shqiptar, 1922-1925, Raport i përmbushjes së punës.



Protokollin përfundimtar i kufirit i vitit 1926 (PRO.FO.371.11203)

Historia e mësipërme tregon se çështja e kufirit tokësor mes Shqipërisë dhe Greqisë është një rast i mbyllur dhe i certifikuar prej më shumë se 90 vitesh. Në arkivat e diplomacisë perëndimore, gjendet i plotë dokumentacioni dhe hartat e sakta të Protokollit të Firences dhe vendimit të 30 korrikut 1926. Kjo është arsyeja që asnjë negociim rregullues nuk mund të zhvillohet mbi kufirin tokësor në mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Përsa i përket kufirit detar në Kanalin e Korfuzit: prej më shumë se 100 vitesh ekziston një metodologji, që ka krijuar precedencë, ka krijuar strukturën e vet përkufizuese për njohjen e vijës ndarëse ujore në mes Shqipërisë dhe Greqisë, në pjesën veriore të Kanalit të Korfuzit. Kjo precedencë është e lidhur me gjithë historinë ndarëse të vijës ujore mes kontinentit dhe ishullit, nga viti 1864, është e sanksionuar edhe në bisedimet dhe rakordimet përfundimtare mes Fuqive të Mëdha para Luftës së Parë Botërore. Në dy nga katër hartat e katër vilajeteve ku shtriheshin tokat shqiptare në prag të Pavarësisë (1912, 1913), të hartuara

nga një prej institucioneve më prestigjioze të gjeografisë, Institutit të Gjeografisë Ushtarake të Romës, tregohet një vijë ndarëse shumë e qartë në Kanalin e Korfuzit, që vijon, si në pjesën veriore ashtu edhe në pjesën jugore, dhe që bashkohet me pjesën kontinentale, duke kaluar përmes ngushticës së Prevezës në P. Skile, diku në mes të Gjirit të Artës ose të Ambrakisë³⁵.

Në qoftë se sot, në vitin 2020, duhet një dokument i shkruar mes dy vendeve para hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE, linja ndarëse mendoj se nuk mund të devijojë pa marrë parasysh njohjen praktike të kufirit detar të konsoliduar nga historia pararendëse. Kjo do të thotë se vija ndarëse kufitare në Kanalin e Korfuzit duhet të jetë e baraslarguar, edhe në pjesën veriore dhe veriperëndimore, në mesin e artë, në mes ishullit të Korfuzit dhe bregut shqiptar, pa llogaritur ishujt e vegjël të varësisë, në veri të Korfuzit (Ereikoussa, Othonoi, Mathraki). Tek ky lloj arsytimi është mbështetur deri vonë (1958, 1982) matja e vijës së kufirit. Mirëpo kanë ndodhur një numër zhvillimesh në të drejtën e detit. Konventa e të Drejtës së Detit e Kombeve të Bashkuara e vitit 1982, në nenin 15, parashikon se, në mungesë të një marrëveshjeje, shtetet nuk mund të shtrijnë ujërat e veta territoriale përtej vijës së mesme, përderisa nuk ekzistojnë rrethana të tjera speciale historike që diktojnë të kundërtën. Distanca e barabartë ose rrethanat speciale janë pranuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë si e drejtë zakonore ndërkombëtare dhe vetëm në raste përjashtimore, distanca e barabartë nuk përbën bazat e kufijve përgjatë ujërave territorialë. A është rasti i kufirit detar mes Shqipërisë dhe Greqisë një rast përjashtimor? Në bazë të parimeve të përcaktuara në 6-mujorin e parë të vitit 1914 nga Fuqitë e Mëdha, distanca e barabartë mes Korfuzit dhe Bregut e Karaburunit edhe në veriperëndim ka qenë thelbi i një ndarjeje të drejtë, d.m.th. logjikisht një rast përjashtimor i kthyer në zakon të respektueshëm vetvetiu prej shteteve, deri vonë. Mirëpo, sot çështja është ringritur sërish mes palëve për t'u fiksuar në një traktat, që dështoi në vitin 2009 dhe po ashtu në vitin 2018.

Këtu qëndron gjithë sekreti i zgjidhjes së problemit sot: ku do të fillojë matja? Dhe a do të njihet precedencë e një ndarjeje të baraslarguar nga toka kryesore dhe jo nga varësitë e saj? Në qoftë se matjet fillojnë nga Ereikoussa, Othonoi, Mathraki me Bregun shqiptar, e gjithë

³⁵ PRO.FO.925.21007.

precedenca bie poshtë, Shqipëria humbet det territorial dhe zonë ekonomike ekskluzive në veri dhe në veriperëndim të ishullit të Korfuzit që i kalon tërësisht Greqisë. Në qoftë se ndiqen parimet precedente, zona naftëmbajtëse do ketë të tjera të drejta shfrytëzimi dhe integriteti territorial i Shqipërisë nuk do të cenohet. Mes njohjes së situatës ekzistuese të njohur historikisht në lidhje me Kanalin e Korfuzit dhe të pretendimit të Greqisë për të aplikuar nenet e LOSC nga varësitë e banueshme ishullore, Ereikoussa, Othonoi, Mathraki, zgjidhja mbetet shqyrtimi gjyqësor bazuar në rastet e ngjashme. Gjithsesi duhet të kujtojmë se Shqipëria ka lëshuar mjaft territor nga lumi Thyamis/Kalamas dhe deri në Kepin Stillos. Nuk besoj se është e përshtatshme që ekzistenca e destabilitetit politik në Shqipëri, të shfrytëzohet si moment nga autoritetet e sotme greke, për të cenuar edhe më tej integritetin e shtetit shqiptar dhe tërësinë e tij territoriale. Taktikat e një kohe të shkuar të historisë së viteve 1919-1926, janë të papranueshme në vitin 2020, kur dy vendet aderojnë në një strukturë strategjike dhe janë aq pranë gjendjes në një bashkësi politike shtetesh të perëndimizueme.

Ndërkohë, negociatat me autoritetet zyrtare të Athinës nuk mund të lenë në hije të drejtat e shtetësisë, të pronësisë së Çamërisë, të shkollimit në gjuhën shqipe dhe të dygjuhësisë, së popullsisë ortodokse shqiptare në Epirin e Jugut aktual. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare duhet të angazhohet që të heqë dorë nga tjetërsimi i pronësisë së fshatrave shqiptare të Bregut (Palasë, Dhërmi, Vuno, Himarë etj.), ku po vërshojnë me grabitje “investitorët” e rinj, të pasuruar rishtazi gjatë viteve të tranzicionit. Respektimi i krahinës së Himarës dhe traditave të saj fillon me respektimin e të drejtave të pronësisë së popullsisë autoktone të kësaj ane. Mbi këto linja duhet të mbështetet kompromisi historik dhe jo mbi cedim të përsëritur të territoreve të shtetit shqiptar, si “taksë” greke për hapjen e negociatave.

S u m m a r y

ON DEFINING THE BORDER BETWEEN ALBANIA AND GREECE

This article deals with the history of the state boundaries established between the last Balkan State created after the dismemberment of European Turkey in 1913, namely the Principality of Albania and the Kingdom of Greece. The course of events is viewed from two different international relations' time contexts. *The first period 1881-1914 and the second 1918-1926.*

The land and sea boundary between Albania and Greece has been essentially a foreign policy's problem, involving not only the two interested parties but also the Great Powers. We are referring to strained relations which have been renewed between the two nations in various forms, after every Balkan and world crisis for almost the entire 20th century.

The author argues that the relations between the two countries were characterized by: 1. A steady attitude of the Greek state to establish a land and sea boundary strategically favorable, disregarding the international rights based on ethnographic, geographic, economic and strategic requirements foreseen in international agreements since at least the Final Act of the Vienna Congress in 1815; 2. An almost insensitive official policy of Greece towards national, anti-ottoman and European interests of the Albanians, and an almost constant support for Serbia against Albania, even in questions in which Greece was remotely related (Kosovo); 3. The permanent inability of the Albanian state to establish institutional political representation which would allow the implementation of the state's territorial integrity and provide freedom for regions with specific ethnic and religious features.

This article provides a complex analysis, in which the study of national and Balkan history is intertwined with the history of international relations, the law of the sea and political science. It is a research study based on primary sources found in the British archives and maps which the Albanian State Archive does not possess.